



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.5/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur me ankesën e parashtruar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me Udhëzuesin Zyrtar për Procedurat e Votimit me Asistencë, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.5/2025 datë 04.12.2025, e parashtruar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me Udhëzuesin Zyrtar për Procedurat e Votimit me Asistencë.

A r s y e t i m

Me datë 04.12.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Shoqata Down Syndrome Kosova, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me Udhëzuesin për votimin me Asistencë, të hartuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor, me te cilën ankesë është theksuar se ky udhëzues ka krijuar praktika që cenojnë të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuara gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet komunale në raundin e dytë për Komunat që shkuan në balotazh (zgjedhjet që u mbajtën me dt.09.11.2025). Tutje, parashtruesja e ankesës thekson se përmbajtja e këtij udhëzuesi nga KQZ-ja, bie ndesh me kornizën kushtetuese, ligjore të vendit dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuara, konkretisht e trajton aftësinë e kufizuar si “sëmundje”, duke e reduktuar në një dimension shëndetësor dhe duke e larguar nga perspektiva e të drejtave të njeriut, barazisë dhe pjesëmarrjes së plotë në procesin zgjedhor. Tutje, në ankesë theksohet se kjo cenon nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 89 të LZP, i cili njeh të drejtën e votimit me asistencë për qytetarët me aftësi të kufizuara që, për shkak të gjendjes së tyre, nuk mund të votojnë vetë, dhe sipas parashtrueses ky udhëzues praktikisht e kufizon këtë të drejtë të garantuar me ligj. Po ashtu, në ankesë theksohet se shkel ligjin nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe në kundërshtim me Konventën e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, nenin 29. Parashtruesja e ankesës tutje thekson se shqetësimin lidhur me udhëzuesin e hartuar nga KQZ e kanë adresuar edhe në KQZ me datë 10.11.2025, por deri tani nuk kanë marrë asnjë përgjigje apo sqarim zyrtar, njëherit ky udhëzues është hartuar dhe miratuar brenda një periudhë shumë të shkurtër kohore, nuk janë konsultuar palët e interesit dhe nuk është

publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, sipas tyre kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në diskriminim dhe pamundësinë e të drejtës për votim të personave me aftësi të kufizuara me asistencë gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve komunale.

Andaj, bazuar në këto rrethana, duke përfshirë tashmë edhe datën e caktuar të zgjedhjeve të reja nacionale, parashtresa e ankesës kërkon nga PZAP të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar të gjitha rregulloret, udhëzuesit, materialet shpjeguese dhe dokumentet e tjera mbi të cilat KQZ, organizon zgjedhjet dhe procesin e votimit të jenë plotësisht në përputhje me rendin kushtetues dhe ligjor, duke eliminuar shkeljet e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe duke garantuar një proces të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Ankesës i janë bashkangjitur dy fotografi të Udhëzuesit, kopje e emailit të dërguar tek KQZ me datë 10.11.2025.

Në përgjigjen në ankesë dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, theksohet se bazuar në nenin 89 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 10 i Rregullores Zgjedhore 12/2025, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim (Raundi I Dytë i Zgjedhjeve) - Faqe 16- 17, përcaktohet procedura e detajuar për votimin me asistencë. Pas miratimit të Procedurës Votimit dhe Numërimit në Vendvotim për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale 2025, KQZ, me qëllim që të sqarojë rregullat dhe procedurat për votimin me asistencë, në mënyrë që çdo qytetar të mund ta ushtrojë të drejtën e tij për të votuar në mënyrë të barabartë, të sigurt dhe të fshehtë, ka nxjerrë Udhëzues për Votimin me Asistencë, i cili ju është dërguar të gjithë stafi të KQZ në teren.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerëson se pretendimet e Shoqatës Down Syndrome Kosova janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pabazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se KQZ-ja, ka krijuar praktika apo udhëzues që cenojnë të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuara gjatë procesit zgjedhor.

Pretendimet ankimore të parashtresës të ankesës se me rastin e hartimit të Udhëzuesit lidhur me Votimin me Asistencë nga KQZ-ja, nuk qëndrojnë, kjo duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 89 par. 6 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t'i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore.”*, ndërsa në nenin 10 paragrafi 5 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit, në mënyrë decisive thuhet se *“votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, kur aftësia e tij e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi)*

nga e njëjta QV, i zgjedhur nga votuesi”. Ndërsa në nenin 10, paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 përcaktohet qartë se “asistuesi mund ta ndihmojë në votim personin me aftësi të kufizuara, duke ia mbajtur dorën dhe mundësuar që votuesi të shënjoj vetë fletëvotimin. Në rast se votuesi nuk mund ta hedhë fletëvotimin në kuti, atëherë asistuesi e ndihmon këtë proces”. Nga dispozitat e lartcekura, Paneli vlerëson se Udhëzuesi zyrtar për procedurat e Votim me Asistencë i dt. 09.Nëntor 2025 i KQZ-së, është i drejtë dhe se i njëjti është në përputhje me dispozitat e LZP-së.

Paneli ka shqyrtuar pretendimet ankimore te ankueses se Udhëzuesi ne fjale nuk është në përputhje me rendin Kushtetues dhe ligjore, dhe ka gjetur se, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë për arsye se, Udhëzuesi për Votim me Asistencë është në përputhje dispozitën e nenit 89 LZP në nenin 10 paragrafi 5 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024. Ndërsa lidhur me pretendimet e ankueses se me Udhëzuesin e tillë është shkel Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga diskriminimi, Paneli shqyrtoj pretendimet e ngritura nga ankuesja, mirëpo vlerësoj se kriteret e përcaktuar për procedurat e votimit me Asistencë i përcaktuar ne këtë Udhëzues nuk konsiderohen diskriminues për Votuesit të cilët janë me aftësi të kufizuara, pasi qe, këto kritere te përcaktuara në Udhëzuesi për Votim me Asistencë të KQZ-së janë në përputhje me Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Duke marrë për bazë të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L–228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.5/2025 datë 05.12.2025

**Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi**



KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L–228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.129/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare, Faton Bajrami dhe Faton Ademi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Shoqata Doën Syndrome Kosova, lidhur me Udhëzuesin Zyrtar për Procedurat e Votimit me Asistencë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.5/2025, të datës 05.12.2025, në seancën e mbajtur më datë, 09.12.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si e pasafatshme ankesa e parashtruar nga Shoqata Doën Syndrome Kosova, lidhur me Udhëzuesin Zyrtar për Procedurat e Votimit me Asistencë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.5/2025, të datës 05.12.2025.

A r s y e t i m

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.5/2025, të datës 05.12.2025, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.Anr.5/2025 e datë 04.12.2025, e parashtruar nga Shoqata Doën Syndrome Kosova, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me Udhëzuesin Zyrtar për Procedurat e Votimit me Asistencë.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Shoqata Doën Syndrome Kosova, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të anulojë vendimin ZP.Anr.5/2025 të datës 05.12.2025 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që para organizimit të çdo procesi zgjedhor të ardhshëm, të rishikojë dhe të harmonizojë Udhëzuesin për Procedurat e Votimit me Asistencë me dispozitat kushtetuese, ligjore dhe me standardet ndërkombëtare që garantojnë të drejtën e votës, duke siguruar që çdo kriter i vendosur të jetë i ligjshëm, proporcional, i zbatueshëm në praktikë dhe të mos pamundësojë ushtrimin e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të Shoqatës Doën Syndrome Kosova, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të hedhet si e pasafatshme ose të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 04.12.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Shoqata Doën Syndrome Kosova, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me Udhëzuesin për votimin me Asistencë, të hartuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor, me të cilën ankesë është theksuar se ky udhëzues ka krijuar praktika që cenojnë të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuara gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet komunale në raundin e dytë për Komunitet që shkuan në balotazh (zgjedhjet që u mbajtën më datë 09.11.2025), duke theksuar më saktësisht si në ankesën e parashtruar në PZAP.

KQZ më datë 05.12.2025, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka dhënë sqarime lidhur me procedurën lidhur me udhëzuesin për procedurat e votimit me asistencë, duke theksuar më saktësisht si në përgjigje në ankesë.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë nga ana e KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.5/2025, të datës 05.12.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e Shoqatës Doën Syndrome Kosova, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ZP.Anr.5/2025, të datës 05.12.2025, Shoqata Doën Syndrome Kosova, ka paraqitur ankesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e pasafatshme, për arsye se:

Me neni 118, paragrafi 4, të Ligji nr. 08/l-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja, mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se ankesa nuk lejohet kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ZP.Anr.5/2025, të datës 05.12.2025, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës të kushtëzuar përveç tjerash edhe me afatin për paraqitjen e ankesës i cili është dyzet e tetë (48) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-së, për të qenë e lejuar ankesa.

Në këtë rast nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës konstatohet se vendimin Shoqata Doën Syndrome Kosova, përmes e-



mailit e ka pranuar dhe konfirmuar më datën 05.12.2025 në orën 15:52h., ndërsa ankesën kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, e ka dorëzuar në Gjykatën Supreme më datë 08.12.2025 në ora 13:20h, e që rrjedhimisht rezulton se ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit prej dyzet e tetë (48) orëve. Në këtë rast afati për paraqitjen e ankesës fillon të llogaritet nga data 05.12.2025 ora 16:52h, ndërsa koha e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës ka qenë 07.12.2025, ora 16:52h, prandaj në këtë rast, ankesa është e palejuar, për shkak se është paraqitur pas afatit ligjorë prej dyzet e tetë (48) orëve.

Për më tepër Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se, në Gjykatën Supreme të Kosovës është e caktuar kujdestaria për pranimin e parashtresave - ankesave sa i përket procesit zgjedhor edhe ditëve të vikendit, në mënyrë që të gjitha palëve tu sigurohet qasja në gjykatë dhe parashtrimi i mjeteve juridike brenda afatit të paraparë ligjor. Prandaj edhe nëse afati i fundit për dorëzimin e parashtresave - ankesave bie në ditët e vikendit, palët nuk kanë pengesa të paraqesin ankesë në gjykatë, sepse dorëzimi i parashtresave - ankesave në Gjykatën Supreme të Kosovës sa i përket procesit zgjedhor mund të bëhet edhe ditëve të vikendit. Në këtë rast duke pas parasysh se afati i paraparë sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, për paraqitjen e ankesave është dyzet e tetë (48) orë, nga momenti i pranimit të vendimit nga ana e PZAP-së, i cili afat është prekluziv, rezulton se ankesa e ankuesit është e pasafatshme.

Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 118.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.129/2025, më datë 09.12.2025.

Kryetare e kolegjit
Franciska Zhitija - Ymeri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP-PRISTIN

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-129/2025

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqinjt, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stani radnom mesin, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribitno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____
Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebuje pečrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTUVNOJIN

09.12.2025

Numri i shitojcave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Atent. 12.12.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Polpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

04
09.50

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analibet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac neplemen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac. napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Em 12/08